

## Mbledhja e gjashtë e Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën

21 nëntor 2008, Bruksel, Belgjikë

1. Grupi Ndërkombëtar Drejtues (ISG) falënderon Shkëlqesinë e Tij Z. Skender Hyseni, Ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, për fjalimin drejtuar anëtarëve të Grupit mbi punën e Qeverisë në përfaqësimin e Kosovës. Gjithashtu, ISG-ja falënderon Shkëlqesinë e Tij Z. Ahmet Shala, Ministër i Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës, për fjalimin drejtuar delegatëve të ISG-së mbi punën lidhur me buxhetin dhe ekonominë e Kosovës.
2. Me më shumë se pesëdhjetë njohje - përfshirë ato nga katër ish-republikat Jugosllave, nga shumica domethënëse e shteteve evropiane dhe nga shtete të të gjitha kontinenteve - Kosova ka arritur shumë progres në konsolidimin e shtetësisë së saj. ISG-ja inkurajon përpjekjet shtesë për të siguruar njohje të mëtejme. ISG-ja mirëpret gatishmërinë e Kosovës për të vazhduar dialogun me të gjithë fqinjët e saj dhe për t'i kontribuar stabilitetit në rajon.
3. ISG-ja ripohon përkushtimin e saj ndaj respektimit të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe akterëve ndërkombëtarë do të avancojë implementimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin (PGJS), përmes të cilin sigurohet krijimi i një Kosove shumetnike të bazuar në vlerat demokratike dhe duke respektuar standardet ndërkombëtare.
4. ISG-ja e rithekson mbështetjen e saj të plotë për përpjekjet e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (ICR), Z. Pieter Feith dhe të Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) për të përkrahur dhe mbikëqyrur implementimin e PGJS-së nga autoritetet e Kosovës dhe për t'i ndihmuar ato në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe shumetnike.
5. ISG-ja mirëpret vendosjen e planifikuar të misionit të EULEX-it në mbarë territorin e Kosovës. ISG-ja thekson rëndësinë e forcimit të sundimit të ligjit. ISG-ja mbështet synimin që EULEX-i të veprojë në përputhje me kornizën institucionale dhe juridike që është në fuqi në Kosovë që nga 15 qershori 2008.
6. Qeveria po bën përpjekje të mëdha për të implementuar decentralizimin dhe po i jep përparësi përmirësimit të arsimit të pakicave. Plan-programet në gjuhët e pakicave duhet të zhvillohen para përfundimit të këtij viti shkollor dhe në këtë pikëpamje do të themelohet një komision i pavarur sa më parë që është e mundur. ISG-ja vë në dukje se kërkohet veprim shtesë për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve. Qeveria ka arritur përparim përkitazi me themelimin e Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi ka miratuar Kodin Doganor si dhe katër ligje të tjera që lidhen me PGJS-në. Qeveria ka vazhduar me privatizimin. Megjithatë, ISG-ja shpreh shqetësimin e saj lidhur me përgatitjet për buxhetin e vitit 2009, në veçanti lidhur me ngritjen e dukshme të shpenzimeve aktuale, përfshirë pagat për sektorin publik. ISG-ja i bën thirrje Qeverisë që të vazhdojë përpjekjet e saj për të promovuar dhe mbrojtur trashëgiminë fetare dhe kulturore siç parashihet në PGJS.
7. ISG-ja mirëpret publikimin nga ICO-ja të Matricës së azhurnuar të Implementimit të Misionit në faqen e saj të internetit ([www.ico-kos.org](http://www.ico-kos.org)). Kjo Matricë përcakton etapat kyçe për implementimin e PGJS-së. Matrica tregon se është arritur një përparim i rëndësishëm gjatë muajve të kaluar. ISG-ja do të vazhdojë me monitorimin e përparimit.
8. ISG-ja përshëndet Presidentin Ahtisaari për marrjen e Çmimit Nobel për Paqe për punën e tij të zellshme në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare, përfshirë përpjekjet e tij të palodhshme që çuan në zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës.